



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Edmond Gashi** me datë **04.11.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, në një masë më të lehtë siç është ajo e “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ose “garancia pasurore” të parashikuara nga nenet 234 e 236 të K.Pr.Penale”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Ardit Mustafaj, bazuar në nenet 228 e vijues, 233, 236 dhe 260, pikat 2 dhe 4 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **627**, datë **08.11.2024**, vendosi:

1. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi”, të caktuar ndaj personit nën hetim **Edmond Gashi** me vendimin nr. 84 regj.them., datë 24.07.2024, të kësaj gjykate, me masën e sigurimit personal “garancia pasurore” të parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale, duke urdhëruar depozitimin e garancisë pasurore në shumën **** lekë brenda 10 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
2. Caktimin ndaj personit nën hetim **Edmond Gashi** të masës së sigurimit personal “ndalim i daljes jashtë shtetit” të parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale.
 - Personit nën hetim **Edmond Gashi** i ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit, duke marrë prokurori masa për bllokimin e këtyre dokumenteve personit nën hetim.
3. Personi nën hetim **Edmond Gashi** do të vijojë të qëndrojë në masën e sigurimit “arrest në shtëpi” deri në depozitimin e garancisë pasurore.
4. Për depozitimin e garancisë pasurore të njoftohet prokurori, i cili të zbatojë parashikimet e nenit 236, pika 5, të K.Pr.Penale.
5. Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Tiranë, më datë **08.11.2024**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar